



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo



Komuna e Prishtinës
Opština Priština –Municipality of Prishtina

E K S T R A K T I P R O C E S V E R B A L I T

i mbledhjes së tetë të Komitetit për Politikë dhe Financa, mbajtur më 5.9.2024, duke filluar në orën 10:00.

Në mbledhje morën pjesë: Fehmi Kupina, kryesues i komitetit, anëtarët e komitetit: Milazim Vitija, Jeta Rafuna, Dhurata Jahaj - Retkoceri, Leutrim Retkoceri, Shegë Beqiri, Arbnora Berisha, Gëzim Sveçla, Nora Kelmendi dhe Mirsad Vitia.

Mungoi: Bahri Gashi.

Në mbledhje ishin të pranishëm edhe: Jehona Lushaku, nënkyetare, Osman Bllaca, auditor, Valbona Makolli, drejtore e Drejtorisë së Financave, Doruntinë Maloku, drejtore e Drejtorisë së Pronës, Arbër Sadiki, drejtor i Drejtorisë së Urbanizmit dhe Planifikimit Mjedisor, Valbona Ajeti, drejtore e Drejtorisë së Administratës dhe Fatos Dibra, udhëheqës i Zyrës ligjore.

Mbledhjen e hapi dhe e kryesoi, Fehmi Kupina, kryesues i komitetit, me këtë

REND DITE:

1. Miratimi i ekstraktit të procesverbalit të mbledhjes së shtatë të Komitetit për Politikë dhe Financa;
2. Propozim-vendimi për ndryshimin dhe plotësimin e Vendimit për caktimin e komisionit për të udhëhequr dhe koordinuar punën në terren në përgjedhjen e këshillave urbane, nr. 01-020/04215695/23, dt. 3.11.2023;
3. Propozim-vendimi për këmbimin e pronës së paluajtshme komunale, me pronën e paluajtshme në pronësi të "4A", SHPK;
4. Propozim-vendimi për këmbimin e pronës së paluajtshme komunale, me pronën e paluajtshme në pronësi të Ruzhdi (Maliq) Ejupit;
5. Propozim-vendimi për këmbimin e pronës së paluajtshme komunale, me pronën e paluajtshme në pronësi të Gafurr (Ismail) Gosalcit, Gazmend (Sylejman) Gosalcit, Shemsi

- (Hemit) Gashit, Hasan (Brahim) Sylës, Vahide (Hasim) Xhumshitet dhe BTP "Holding" SHPK;
6. Propozim-vendimi për ndryshimin e riparcelimit sipas gjendjes aktuale kadastrale (të banimit individual) të Planit rregullues "Prishtina e Re - Zona perëndim", dhe ndërrimin e destinimit të BLL. I-1, Q-2, I-2, sipas destinimit të PZHU-së, në Prishtinë;
 7. Propozim-vendimi për ndarjen e mjeteve ndërmarrjes publike lokale "Kuzhina Qendrore" SHA, në Prishtinë;
 8. Raporti i punës i Ndërmarrjes publike lokale "Stacioni i Autobusëve", SHA, Prishtinë;
 9. Raporti i punës i Ndërmarrjes publike lokale për vitin 2023-2024, "Sport Marketing", SHA;
 10. Informatë mbi punën e Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi;
 11. Të ndryshme.

Para se të fillonin me diskutimet për pikat e rendit të ditës, **Jehona Lushaku** tha se i ka dërguar propozimet për dy pika, një propozim për një informim rrëth mësimit tërëditorë, në seancë në këtë mbledhje, e nuk e di pse nuk është përfshirë, përvèç subvencionimit të NPL "Kuzhina Qendrore".

Osman Bllaca tha se e kam edhe unë pikën Raportin e auditorit për ta shqyrtuar, por nuk ju ka ardhur z. kryesues në e-mail dhe nuk është përfshirë si pikë.

Gëzim Sveçla pyeti se a ju ka ardhur një e-mail nga Hasan Zeneli, kërkesë për pëlqimin e vendosjes së një busti të Heroit të Kombit Jonuz Zeneli.

Kryesuesi bëri të ditur se e ka marrë atë kërkesë dhe ka mbetur të përcillet në Urbanizëm për procedurat e mëtejme.

Gëzim Sveçla pyeti se a ka ndonjë raport të punçs të kryetarit, sepse sipas ligjit duhet dy herë me raportuar kryetari për punën e tij.

Leutrim Retkoceri theksoi se buxheti duhet votuar në shtator, andaj pse nuk është në këtë seancë.

Gëzim Sveçla u shpreh se zakonisht kjo bëhet me seanca të jashtëzakonshme, kështu është bërë edhe në të kaluarën.

Jehona Lushaku theksoi se e-mailin e gjeta që ju kam drejtuar juve me kërkesën për dy pika për t'i përfshirë në këtë seancë: "Informim mbi organizimin mësimor gjithëditor në shkollat e kryeqytetit dhe "Suvencionimi i NPL "Kuzhina Qendrore"".

Gëzim Sveçla pyeti nën kryetaren se a mundemi me i lënë për seancën e ardhshme, sepse kjo seancë është e ngarkuar shumë.

Nora Kelmendi tha se edhe kjo, edhe pika e auditimit munden me shkuar për seancën e ardhshme.

Gëzim Sveçla pyeti kryesuesin se a mundeni iu drejtuar Kryetarit me një kërkesë prej KPF-së për Raportin e punës, sepse e ka për detyrë sipas Ligjit të vetëqeverisjes lokale dy herë në vit me raportuar dhe ne jemi në shtator, ku ende nuk ka raportuar asnjëherë.

Kryesuesi theksoi se po e fusim si rekomandim.

Leutrim Retkoceri u shpreh se kërkesa që na u ka drejtuar nga Hasan Zeneli, kjo përgjegjësi është e Drejtorisë së Urbanizmit dhe do ishte mirë me iu bashkëngjittë seancës së ardhshme, me ardhur me

propozime për kërkesën ose të refuzohet, ose të vijnë me propozime.

Osman Bllaca tha se i kemi dy rekomandime për Raportimin 6-mujor të punës për Kryetari për vitin 2024, si dhe për kërkesën e bërë nga Hasan Zeneli, për pëlgimin e vendosjes së bustit të Heroit të Kombit Jonuz Zeneli.

Kryesuesi e hodhi në votim rekomandimin për Raportimin 6-mujor të punës për Kryetari për vitin 2024.

Kryesuesi konstatoi se me 9 vota për, shkon ky rekomandim.

Kryesuesi e qiti në votim rekomandimin për pëlgimin e vendosjes së bustit të Heroit të Kombit Jonuz Zeneli.

Kryesuesi: konstatoi se me 10 vota për, shkon ky rekomandim.

Pika e parë

Miratimi i ekstraktit të procesverbalit i mbledhjes së shtatë të Komitetit për Politikë dhe Financa.

Kryesuesi konstatoi se u miratua unanimisht ekstrakti i procesverbalit të mbledhjes së shtatë të Komitetit për Politikë e Financa.

Pika e dytë

Propozim-vendimi për ndryshimin dhe plotësimin e Vendimit për caktimin e komisionit për të udhëhequr dhe koordinuar punën në terren në përgjedhjen e këshillave urbane, nr. 01-020/04215695/23, dt. 3.11.2023

Lidhur me Propozim-vendimi për ndryshimin dhe plotësimin e Vendimit për caktimin e komisionit për të udhëhequr dhe koordinuar punën në terren në përgjedhjen e këshillave urbane, nr. 01-020/04215695/23, dt. 3.11.2023, në pika të shkurta dha sqarime Valbona Ajeti, duke cekur se kjo pikë ka hyrë në rendin e ditës në seancën e kaluar dhe është e domosdoshme që të vazhdojë, sepse ne jemi në procesin e krijimit të këshillave të ri lokalë, ku i kemi edhe 18 prej tyre, këtu është edhe zëvendësimi im si asambliste edhe propozimi ka qenë për me u zëvendësuar unë si asamblistë, ky është arsyetimi im i shkurtër për këtë pjesë.

Gëzim Sveçla tha se ky vendim nuk po thotë zëvendësimin tënd si asambliste, zëvendësimin e Viganit me ty në pozitën e drejtorit, apo drejtoreshës së Administratës.

Valbona Vitija dha sqarime lidhur me çështjet e cekura nga parafolësi.

Mirsad Vitia tha se këtu po thotë vetëm drejtorët, d.m.th. po nderohen.

Leutrim Retkoceri u shpreh se këtu është gabim teknik, i kanë lënë vendimet e vjetra që kanë qenë.

Jeta Rafuna theksoi se ky vendim duhet të ndryshohet.

Leutrim Retkoceri tha se në këtë vendim bën plotësim-ndryshimin e komisionit, ku përfshihet Valbona dhe asamblisti tjetër që vjen.

Kryesuesi konstatoi se u përkrah Propozim-vendimi për ndryshimin dhe plotësimin e Vendimit për caktimin e komisionit për të udhëhequr dhe koordinuar punën në terren në përgjedhjen e këshillave urbane, nr. 01-020/04215695/23, dt. 3.11.2023 dhe dërgohet në Kuvend për miratim.

Pika e tretë

Propozim-vendimi për këmbimin e pronës së paluajtshme komunale, me pronën e paluajtshme në pronësi të "4A", SHPK

Lidhur me Propozim-vendimi për këmbimin e pronës së paluajtshme komunale, me pronën e paluajtshme në pronësi të "4A", SHPK, në pika të shkurtra dha sqarime Doruntinë Maloku. Për parcelat që këmbehen. Ajo theksoi se janë njoftuar nga një palë që e ka bërë një ankesë për Ministrinë e Planifikimit në lidhje me këtë lëndë. Besoj se në fillimin e seancës ne do kemi materiale shtesë sa i përket ankesës së palës dhe do ta plotësojmë këtë pikë të rendit të ditës.

Nora Kelmendi pyeti se për çfarë është ankesa.

Doruntinë Maloku u përgjigj se ankesa e palës është në lidhje me kushtet që janë ndryshuar në ndërtim.

Nora Kelmendi i parashtrroi pyetje Doruntinës, se përse nuk janë dërguar përmes e-mail-it punimet e parcelave, zakonisht i dërgoni ju si Drejtori e Pronës në Planifikim, pastaj planifikimi ju dërgon përgjigje, çfarë destinimi kanë parcelat. Jam duke folur për tri këmbimet.

Doruntinë Maloku dha sqarim.

Nora Kelmendi kërkoi që të sillet destinimi i secilës parcelë që del në këmbim, të na i dërgoni deri të hënën.

Leutrim Retkoceri pyeti se pse kanë ardhur këto pika për këmbim, cila është arsyja.

Doruntinë Maloku dha sqarim për çështjet e cekura nga parafolësi.

Leutrim Retkoceri pyeti se sa plane rregulluese janë në Prishtinë, qe njerëzit e kanë të pamundshme me realizuar këmbimin dhe që presin 20 vjet, nuk iu realizohet as këmbimi, as shpronësimi.

Unë kisha kërkuar që ankesa, nëse ka, dhe ju ka përcjellë kryesues, me na i përcjell edhe neve, të dimë çfarë janë këto ankesa ne lidhje më këmbime. Drejtoreshë edhe për shkak të transparencës, më pasur një listë të kérkesave se kur ato kérkesa kanë me u përbyllur dhe kur këmbehen.

Kryesuesi theksoi se ankesat ua përcjelli pa problem.

Doruntinë Maloku bëri të ditur se proceset e këmbimeve ndodhën dhe zhvillohen nëpërmjet disa mënyrave, secila prej këtyre mënyrave në asnje variant nuk përfshin iniciimin direkt të Drejtorisë së Pronës dhe këmbimit, kérkesa ka ardhur nga kryetari, që të fillojë procesi për këmbimin e pronave për gjithë planin.

Leutrim Retkoceri tha se nëse doni me na ofruar besueshmërinë lidhur me këmbimet, sillna kérkesën dhe listën e qytetarëve që bëjnë kérkesë për këmbime, ndërtues të gjitha, vetëm t'i shohim ne se cila ka më shumë peshë për ndërtuesit si votues asamblistë, se kemi shembuj në praktikë më të dëshmuar, që propozimet të cilat kanë ardhur dhe janë realizuar, kanë dalë me qenë më shumë mashtirim se që ka interes publik, iu ka mundësuar dikujt më ndërtuar si ka pasur dëshirë, ku interes publik nuk ka pasur fare. Për këtë po kam dëshirë me na e sjellë ketë listë më diskutuar dhe më pa qytetarët vetë, ti shohim të gjithë qysh po vjen mundësia, pastaj ne vendosim a me këmbyer për ndërtim apo me këmbyer për interes publik, apo si thotë ligji.

Fatos Dibra tha se është e vërtetë që këmbimi i njëjtë nuk lejohet për realizim të planit rregullues për pjesën e planit të ndërtimit. Toka që merret duhet me qenë gjithsesi interes publik, përndryshe nuk mund të bëhet. Nëse ka të tilla atëherë është gabim.

Nora Kelmendi tha nëse toka është interes publik, çdo interes publik duhet me u votuar në Kuvend, që kjo parcelë është interes publik, ajo votohet para së të vije për këmbim.

Fatos Dibra bëri të ditur se Ligji për këmbim thotë se me shpallur interes publik në Kuvend ose të cilat janë të miratuara më planin rregullues. Me plan rregullues është i miratuar interesi publik, është miratuar në Kuvend.

Nora Kelmendi parashtroi pyetjet: Ekzistojnë disa parcela të cilat kanë ardhur në këmbime, për me u këmbyer disa raste, këto i kamë kundërshtuar mos më i hequr si pika të rendit të ditës. Kur ka qenë rasti i Badocit, e keni edhe këtu, asnjëherë si keni sjellë ato dy këmbime, e unë e kamë kundërshtuar që me u hequr ato dy këmbime, edhe ata kanë qenë për interes publik, i keni hequr ato dy këmbime prej dhjetorit asnjëherë nuk i keni sjellë.

Doruntinë Maloku dha sqarime lidhur me pyetjet e parashtruara nga parafolësja.

Leutrim Retkoceri tha se ka raste, ku për disa këmbime është kthyer nga ministritë e linjës që nuk ka qenë në rregull dhe ato të njëjtat ku kanë mbetur, a janë kthyer në Kuvend me i anuluar, apo me i shtyrë përpara, dhe, e dyta, nëse vjen rasti që po vijnë këmbimet për mu realizuar Plani rregullues me filluar ndërtimi, në rast se nuk behet këmbimi, e kthen Ministria, a ka të drejtë ai më filluar më ndërtuar ndërtesën dhe më përfundua, çfarë thotë ligji për këto raste.

Fatos Dibra dha përgjigje për pyetjen e parashtruar nga parafolësi.

Leutrim Retkoceri tha se, d.m.th për me prurë ata, duhet me e propozuar si të njëjtë për me e pruar prapë, apo?

Fatos Dibra tha se duhet me e kthyer në Kuvend për me e lajmëruar në Kuvendë që shqyrtimi ka mbërri me kohë, është në kundërshtim me ligjin që kanë thënë ata dhe Kuvendi komunal vendos se a donë me rishikuar vendimin apo donë me e lanë të njëtin fuqi.

Gëzim Sveçla tha pse po e thua ketë të fundit, për shkak se kur po kthehen nga Ministria, nuk po thotë a donë me e lanë apo donë me ndryshuar, veç thotë se udhëzohet Kuvendi komunal që vendimin ta përshtatë sipas ligjeve në fuqi. Po ashtu tha se këtu s'kemi përgjigje a mundemi me pasur listën e kërkesave të qytetarëve të cilët kërkojnë këmbime sipas ligjit që ju takon e drejta më kerkuar këmbime të pronës së Komunës për me i realizuar të drejtat e veta. Pse se kemi atë listë?

Doruntinë Maloku tha se nuk e ka kerkuar askush atë listë.

Nora Kelmendi u shpreh se në fillim të mandatit e kamë kerkuar.

Doruntinë Maloku bëri të ditur se kërkesa bëhet në formë zyrtare, nuk kanë sjellë dokumente zyrtare, kërkesa.

Gëzim Sveçla kerkoi ta dijë se si shërbehen këta qytetarë, a është kush vjen i pari i përfundon shërbimet i pari, apo ka ndonjë procedurë tjetër.

Doruntinë Maloku tha tash varet se çfarë natyre është kërkesa.

Gëzim Sveçla tha se duhet me i trajtuar të gjitha njëjtë. A ndodhë që ka ardhur një kérkesë që 6 muaj, nuk e ke shqyrtuar fare, apo nuk e ke udhëzuar që më shkuar te Investimet Kapitale apo kudo qoftë, dhe ka ardhur një kérkesë tjetër që 3 muaj, e ke marrë ketë të 3 muajve dhe po e procedon tutje. A mundem zyrtarisht me e kerkua me ma dërguar ne e-mail. Lista e kërkesave të qytetarëve për këmbim të pronës.

Doruntinë Maloku tha se nuk mundem me e bërë shpejt, sepse kam shumë pak staf, për shkak se janë në pushim dhe vazhdimisht jam duke punuar me staf të reduktuar.

Gëzim Sveçla tha se unë tash kam me e bërë dhe është afati ligjor 7 ditë.

Doruntinë Maloku tha se ti e din se listën për me e përpiluar duhet me e shikuar Arkivin.

Nora Kelmendi u shpreh se nëse e keni evidencën, e keni listën, nëse nuk mbanë evidencë, nuk shkon me rendë nuk e ka listën.

Leutrim Retkoceri tha se përveç kësaj, vazhdon të jetë edhe një obligim që e keni, me i trajtuar çështjet e këmbimeve që i ka kthyer Ministria, përveç Badocit, siç është trajtuar edhe herëve tjera, tha mos të bëjmë edhe ne kërkesë me dokumente, t'i shikojë dhe e sjellë, është detyrë, nëse nuk i bini nuk ka logjikë më sjellë këmbime të reja, përderisa të vjetrat më shkelje ligjore nuk trajtohen.

Kryesuesi konstatoi se u përkrah Propozim-vendimi për këmbimin e pronës së paluajtshme komunale, me pronën e paluajtshme në pronësi të "4A", SHPK dhe dërgohet në Kuvend për miratim.

Pika e katërt

Propozim-vendimi për këmbimin e pronës së paluajtshme komunale, me pronën e paluajtshme në pronësi të Ruzhdi (Maliq) Ejupit.

Lidhur me Propozim-vendimi për këmbimin e pronës së paluajtshme komunale, me pronën e paluajtshme në pronësi të Ruzhdi (Maliq) Ejupit, në pika të shkurta dha sqarime Doruntinë Maloku për parcelat që këmbehen.

Gëzim Sveçla tha se ju përgëzo drejtoreshë, se pas 2 vite e gjysmë na ke dëgjuar dhe keni filluar më i bërë vlerësimet paraprakisht para se me i sjellë vlerësimet në Kuvendë.

Doruntinë Maloku e përgëzoi ministrin Milazim Krasniqi dhe MAPL-në që ka vendosur me e shfrytëzuar Manualin të cilin MAPL ja vetë e ka bërë.

Kryesuesi konstatoi se u përkrah Propozim-vendimi për këmbimin e pronës së paluajtshme komunale, me pronën e paluajtshme në pronësi të Ruzhdi (Maliq) Ejupit dhe dërgohet në Kuvend për miratim.

Pika e pestë

Propozim-vendimi për ndryshimin e riparcelimit sipas gjendjes aktuale kadastrale (te banimi individual) të Planit rregullues "Prishtina e Re - Zona perëndim", dhe ndërrimin e destinimit të BLL. I-1, Q-2, I-2, sipas destinimit të PZHU-së, në Prishtinë.

Lidhur me Propozim-vendimin për ndryshimin e riparcelimit sipas gjendjes aktuale kadastrale (te banimi individual) të Planit rregullues "Prishtina e Re - Zona perëndim", dhe ndërrimin e destinimit të BLL. I-1, Q-2, I-2, sipas destinimit të PZHU-së, në Prishtinë në pika të shkurta dha sqarime Doruntinë Maloku, për parcelat që këmbehen.

Nora Kelmendi: u shpreh se edhe për këtë pikë nevojiten destinimet.

Kryesuesi konstatoi se u përkrah Propozim-vendimi për ndryshimin e riparcelimit sipas gjendjes aktuale kadastrale (te banimi individual) të Planit rregullues "Prishtina e Re - Zona perëndim",

dhe ndërrimin e destinimit të BLL. I-1, Q-2, I-2, sipas destinimit të PZHU-së, në Prishtinë dhe dërgohet në Kuvend për miratim.

Pika e gjashtë

Propozim-vendimi për ndryshimin e riparcelimit sipas gjendjes aktuale kadastral (të banimi individual) të Planit rregullues "Prishtina e Re - Zona perëndim", dhe ndërrimin e destinimit të BLL. I-1, Q-2, I-2, sipas destinimit të PZHU-së, në Prishtinë.

Lidhur me Propozim-vendimin për ndryshimin e riparcelimit sipas gjendjes aktuale kadastral (të banimi individual) të Planit rregullues "Prishtina e Re - Zona perëndim", dhe ndërrimin e destinimit të BLL. I-1, Q-2, I-2, sipas destinimit të PZHU-së, në Prishtinë, në pika të shkurtra dha sqarime Arbër Sadiki. Ai tha se se si material nuk ka diçka që kam me shtuar, se disa herë e kam diskutuar, kjo është hera e tretë, duke i shtuar edhe disa materiale nga pyetjet e bëra që dëshirova me ju shpjeguar, faktikisht me u marrë me seksionet e fundit, për mua është super me rëndësi. Për atë ju kisha thanë jepeni mundësinë të shkojë në Kuvend dhe secili të vendosë për votën e vetë.

Kryesuesi konstatoi se u përkrah Propozim-vendimi për ndryshimin e riparcelimit sipas gjendjes aktuale kadastrale (të banimit individual) të Planit rregullues "Prishtina e Re - Zona perëndim", dhe ndërrimin e destinimit të BLL. I-1, Q-2, I-2, sipas destinimit të PZHU-së, në Prishtinë, dhe dërgohet në Kuvend për miratim.

Pika e shtatë

Propozim-vendimi për ndarjen e mjeteve ndërmarrjes publike lokale "Kuzhina Qendrore", SHA, në Prishtinë.

Lidhur me Propozim-vendimi për ndarjen e mjeteve ndërmarrjes publike lokale "Kuzhina Qendrore", SHA, në Prishtinë, në pika të shkurtra dha sqarime Jehona Lushaku, tha se "Kuzhina Qendrore" ka bërë kérkesën në bazë të kérkesës që kemi bërë ne, që të fillojnë përgatitjet për mësimin tërëditor në 5 shkolla, që do të fillojnë në fillim të shatorit, domethënë do të kompensohen të pestat në shtator. Kuzhina i ka bërë përgatitjet, ka blerë vutura enkas, kuzhina mobilare të cilat vendosën në shkolla, në hapësirat e kuzhinave, dhe ka kérkuar një përkrahje subvencionimi prej 129 mijë euro.

Gëzim Sveçla pyeti se pse bëhet kaq vonë kjo kérkesë, po flasim për kuzhina për shkollat ku ka filluar procesi mësimor. A jemi vonë deri të fillojnë këto procedura të tenderimit të këtyre kuzhinave, vendosja, montimi etj?

Jehona Lushaku: dha sqarime, duke thënë se faktikisht janë blerë, janë siguruar mjetet nga kuzhina fillimisht, pastaj subvencionimi bëhet për me u bërë procedurat, e këto të gjitha janë përfunduar, janë vendosur.

Gëzim Sveçla theksoi se nëse janë blerë dhe i kanë pasur mjetet, pse po kërkojnë mjete.

Jehona Lushaku tha se tani ka nevojë për shujta.

Gëzim Sveçla tha se nëse është për shujta duhet shkruar për shujta. Neve po na kérkohen mjete për

me i blerë disa kuzhina, duhet me qenë e qartë për çka po i kërkon Kuzhina këto mjete, për shujta apo me blerë kuzhina, vendimi dhe kérkesa duhet me qenë tjetër, për çfarë po kerkohen 129 mijë euro.

Jehona Lushaku u shpreh se Vendimi për mësim tërëditor është marrë në një fazë kur ne kemi qenë të sigurt që të gjitha përgatitjet e tjera, përveç kuzhinës, janë bërë, domethënë janë bërë shkollat, janë bërë shumë parapërgatitje, dhe vendimin nuk e kemi marrë deri kur kemi qenë të sigurt që gjithçka është gati. Tani kuzhina ka pasur nevojë me i rritur kapacitetet brenda që i ka menaxhuar me buxhetin e saj, i ka rritur kapacetet, e ka rritur kuzhinën, i ka bërë disa investime, ka marrë edhe 10 vetë në punë për këto 5 shkolla nga dy servisere. Kuzhina ka nevojë për mbështetje për përgatitje të mësimit tërëditor, kérkesa është për këto mjete.

Gëzim Sveçla tha se vendimi i datës 13-të të seancës, këto procedura të prokurorimit nuk kanë shanse teorike me u kryer para vitit të ri. Ne me vendos me 13 ka procedura të ligjshmërisë së vendimit 15 ditë, 7 ditë Komuna, pastaj fillojnë procedurat e tenderimit brenda kuzhinës për blerjen e këtyre pajisjeve, këtu diçka nuk është në rregull!

Jehona Lushaku tha se a i kanë kryer kuzhinat procedurat e prokurorimit, me gjasë ata i kanë blerë me para të veta.

Gëzim Sveçla pyeti se çka është 850 mijë euro kontratë e negociuar për kuzhina, është një kontratë e negociuar, e nënshkruar, 850 mijë euro e ka vlerën, prej Komunës.

Jehona Lushkau dha përgjigje, duke thënë se ajo është për ndërtesat, se tri shkollat nuk kanë kuzhina fare. Ato janë ndërtesa aneks, modulare, si aneks që montohen.

Gëzim Sveçla pyeti se kur do të ndërtohet ai aneks, aneksi a ka me u ndërtuar deri më 30 shtator.

Jehona Lushkau bëri të ditur se janë qitë pllakat, janë duke u montuar ato, domethënë ajo është kryer si procedurë, më 30 shtator mbahet mësimi tërëditor në ato anekse.

Gëzim Sveçla: Nëse e kanë kryer procedurën, nuk kemi nevojë me ia dhënë paratë, se paratë i paskan pasur.

Jehona Lushaku dha sqarime për këto çështje.

Gëzim Sveçla: Është mirë me na i sjellë materialet, unë mendoj që është dashtë me qenë këtu kryeshefi i ndërmarrjes ose ndonjë aksionar, me e bërë këtë propozim, jo drejtoresha e Arsimit, se nuk je as aksionare dhe mundesh mos me pasur informata.

Leutrim Retkoceri shprehu mendimin se kishte qenë më mirë me u thirr një seancë e jashtëzakonshme.

Unë çka pres është që mjetet që ndahen me qenë mirë të menaxhuara nga ndërmarrja. Besoj që ka me qenë dikush prej ndërmarrjes me arsyetuar. E dyta, çmimet që na u kanë ofruar me pasur një mbështetje, se dyshoj që janë çmime shumë të larta për shkak të tregut, ka oferta shumë më të lira që kishe mundur me rritë. Po ashtu, kontratat burimore, kontrata e negociume, unë nuk e di pse e kanë logjikën me funksionuar përderisa t'i jepet dikujt në vazhdimësi, sepse kanë mundësi me i interpretuar që janë të favorizueshme.

Jehona Lushaku dha sqarime për çështjet e cekura nga parafolësi dhe tha se do t'uua dërgojë një e-mail dhe të kërkojë të gjitha këto informacione si ka shkuar edhe për punën e çmimeve dhe të gjitha

dokumentet që i kanë, dhe do t'ua përcjell juve.

Milazim Vitija shprehu mendimin se është një pikë shumë e ndjeshme çështja e kuzhinave për nxënësit që do të ushqehen, është hera e parë që kemi mësimin tërë ditor. Unë i kisha propozuar këtij kuvendi që në seancë t'i kemi aksionarët edhe kryeshefin ekzekutiv dhe i jep sqarimet e duhura sa i përket kësaj pike, sepse me sa po e shoh unë, është urgjente, që nëse dëshirojmë në shtator me filluar me i ushqyer të gjithë këta nxënës, atëherë duhet urgjentisht ta kalojmë këtë pikë dhe mjetet t'i ndahet Kuzhinës Qendrore.

Kryesuesi konstatoi se u përkrah **Propozim-vendimi për ndarjen e mjeteve ndërmarrjes publike lokale "Kuzhina Qendrore", SHA, në Prishtinë** dhe dërgohet në Kuvend për votim.

Pika e tetë

Raporti i punës së Ndërmarrjes publike lokale "Stacioni i Autobusëve", SHA, Prishtinë.

Kryesuesi tha se aksionarët nuk janë këtu për me na informuar për këtë raport.

Nora Kelmendi u shpreh se më 23 korrik kam kërkuar për qasje në dokumente publike për ndërmarrjen "Stacioni i Autobusëve", asgjë nuk më është kthyer!

Kryesuesi konstatoi se u përkrah **Raporti i punës së Ndërmarrjes publike lokale "Stacioni i Autobusëve", SHA, Prishtinë**, dhe dërgohet në Kuvend për diskutim.

Pika e nëntë

Raporti i punës së Ndërmarrjes publike lokale për vitin 2023-2024, "Sport Marketing", SHA.

Gëzim Sveçla tha se këtyre të ndërmarrjes "Sport Marketing" duhet me ua qitur rrogat, ata ende nuk i kanë marrë, ju si nënkyetare me e ngritur si shqetësim.

Kryesuesi konstatoi se u përkrah **Raporti i punës së Ndërmarrjes publike lokale për vitin 2023-2024 "Sport Marketing", SHA** dhe dërgohet në Kuvend për diskutim.

Pika e dhjetë

Informatë mbi punën e Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi.

Kryesuesi konstatoi se u përkrah **Informatë mbi punën e Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi** dhe dërgohet në Kuvend për diskutim.

Të ndryshme

Gëzim Sveçla tha kryesues, këto kërkesa që i kemi bërë me ia drejtuar kryetarit, a mundeni me na futur në "CC" neve shefave të grupeve parlamentare.

Fehmi Kupina theksoi se mund ta bëjë një gjë të tillë.

Ai theksoi se e kam një kërkesë nga përfaqësuesit e Sindikatës së shërbyesve civilë të Komunës, që ka

të bëj më shujtën. Ne e dimë që shujta nuk mund të realizohet ashtu si duhet, por me e gjetur një mënyrë, si ka mundësi një pako ushqimore me ia bërë, ne mundemi me e futë dhe e votojmë.

Milazim Vitija tha le ta votojmë dhe të kalojë në Kuvend dhe përmbaruesi le të merret me atë punë dhe përgjegjësia të mbetet te ne.

Gëzim Sveçla bëri të ditur se pako ushqimore është e gjetur e auditorit, subjekti yt ka grup parlamentar që mundet me iniciuar plotësim-ndryshim të ligjit edhe me u bërë kjo punë, çështja është e nivelit qendor. Duhet me pasur fuqi si subjekte, jo si asamblist, kemi anëtarë të kryesisë, nënkyetarë të qyteteve që janë kryetarë të degëve të juaja, me i ngritur këto çështje.

Jehona Lushaku shprehu mendimin se këtu duhet shumë seriozisht me u qasur, përmbaruesit janë duke na marrë buxhet kudo, edhe ti vetëm vjen në fund të vitit edhe e sheh që nuk ke buxhet as për paga, e mendoj që këtu duhet krejt subjektet me u ulur edhe seriozisht me menduar, kjo është mbi gjithçka kur të rrezikohet buxheti komunal, domethënë komunat janë momentalisht në krizë. Unë mendoj që kjo duhet shumë seriozisht me u diskutuar.

Fatos Dibra tha tani nuk e di, por përpara më ka ardhur edhe mua një e-mail, domethënë kur shkon diçka në përmbarim, bëhet i pambarueshëm, thesari të pyet për 24 orë ku po dëshiron ti me i marrë paratë.

Jehona Lushaku tha se fakti që po t'i merr, Fatos a po kupton, po ta prish kompletni planifikimin, mua po m'i merr pagat e shkollave fillore tani për mësim tëreditor, e kishte zvogëluar buxhetin aty ku më duhej më së shumti.

Osman Bllaca tha se në nivel të Komunës flitet shumë te punëtorët për shujta, edhe kanë kërkesë për këto shujta. Auditori ka kërkuar, auditori i jashtëm dhe i brendshëm, që nuk bënë më me u bërë, por është një lloj presioni i punëtorëve për këto shujta. Ajo që është edhe më e keqja, se ndërmarrjet ne vetë i subvencionojmë, ato marrin shujta nga 5 euro në krejt ndërmarrjet tona për ditë, e ne punëtorët e Komunës nuk marrim!

Gëzim Sveçla tha se ndërmarrjet nuk i nënshtrohen ligjit të pagave, deri sa të gjendet zgjidhja prej nivelit qendor. Plotësim-ndryshimi i ligjit të pagave ia lejon edhe shujtat në mënyrë ligjore, krejt votat tona janë vetëm të gjejnë një mënyrë ligjore. Unë e kam pyetur personalisht edhe ministrin për këtë punë. I kam takuar edhe përfaqësuesit e Sindikatës së Komunës.

Leutrim Retkoceri pyeti Jetën se a kanë diskutuar me kryetarin e Komunës për këtë çështje.

Jeta Rafuna u përgjigj, duke thënë se kanë diskutuar dhe ai po thotë vetëm gjene mënyrën ligjore.

Leutrim Retkoceri tha qenka zgjidhja në mes, me e bë një vendim që përmbaruesi i merr dhe me bërë zgjidhje.

Jeta Rafuna tha se ne diskutojmë edhe një herë me kryetarin e te shohim si do bëhet.

Mbledhja përfundoi në orën 11:40.

Procesmbajtësja
Shyhrete Islami

Kryesues i Komitetit
Fehmi Kupina



Faqe 10 nga 10